



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 87

Prishtinë, më 19.07.2013, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinkovic, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme- Naim Shala, Departamenti Ligjor, Shkodran Manaj, Drejtor, Kolonel, Rrahman Sylejmani, Policia Kufitare, Minire Begaj-MPMS, Ekrem Zeqiri, Zyratr Ligjor në MPB, Mentor Hoxha, Zyratr Ligjor në MPB, Safete Bilalli, Zyrtare Ligjore në MPB, Ilaz Rudaku- DSHAM, Avdyl Hyseni-Zyrtar Ligjor në MPB, Habibe Zeqiri, Departamenti për Azil në MPB, Kolonel Ragip Bunjaku-Policia Kufitare, Bekim Kodraliu-OSCE.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSCE, Dhurata Kryeziu- OSCE,

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Fatmir Xhelili, Kryesues i grupit punues për shqyrtimin e projektligjeve në rend dite.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-219 për të Huajt.
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-217 për Azil.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesi- Filloi takimin duke njoftuar se me vendim të Komisionit është formuar grupi punues i cili do të bëjë përgatitjen e këtyre projektligjeve për lexim të dytë, grupi punues në përbërje ka të gjithë anëtarët e Komisionit.

Fillimisht kërkoi që të përcaktohet mënyra e punës, pasi këto ligje janë ardhur me procedua të përsheptuar dhe duke shmang rregulloren e punës së Kuvendit kanë hyrë në lexim të parë, prandaj kërkoi që të përcaktojmë mënyrën e punës, duke filluar leximin e projektligjeve nen për nen, apo të merret në konsideratë profesionalizmi dhe analizimi që i është bërë nga zyrtarët përgjegjës të MPB-së.

Anëtarët e Komisionit kanë shprehur gatishmërinë që të përkrahin këtë proces, duke iu shmangur procedurës së rregullt.

Tutje fjalën ia kaloi z. Shala dhe z. Mani, për të dëgjuar qëndrimin e tyre për këto projektligje

Naim Shala- Theksoi se këto projektligje janë nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave dhe se nga viti i kaluar ka filluar analizimi i tyre me ato të direktivat e BE_së, dhe vetëm njëri nga ta ka dalë në mos koherencë me direktivat e BE-së, dhe ky është Ligji për të Huajt. Gjithashtu pas pranimi të vërejtjeve nga Komisioni Evropian për disa terminologji në këto projektligje, janë marrë masa dhe janë bërë përmirësimet. Dhe harmonizimet.

Shkodran Mani- Pas pranimi të komenteve nga Komisioni Evropian, ato janë përfshirë në projektligje, ndërsa për Projektligjin për të Huajt kemi disa amendamente të cilat do të prezantojmë për Komisionin dhe propozoi që të vazhdohet me leximin nen për nen të projektligjeve.

Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit- Fillimisht propozoi që të përcaktohet metodologjia e punës duke vazhduar tutje me trajtimin e këtyre projektligjeve, në mënyrë pas përfundimi të tyre të kalojnë pa vërejtje në Kuvend si dhe të përmbushin standardet evropiane, gjithashtu falënderoi z. Xhelili për kryesimin e këtij grupi punues.

Rexhep Selimi- Për metodologjinë e trajtimit të këtyre projektligjeve, vërejtje ka qenë koha e shkurtër për trajtimin e tyre në mënyrë adekuate, duke qenë se janë kaluar me

procedurë të përshpejtuar, por që si anëtar të Komisionit do të merremi me shqyrtimin e tyre duke mos e cenuar cilësinë e projektligjeve.

Fatmir Xhelili- Propozoi që sot të punohet në tre projektligje, Projektligjin për të Huajt, Projektligjin për Shtetësi dhe Projektligjin për Azil, ndërsa të nesërmen në ora 09:00 vazhdohet me tre projektligjet e tjera.

Tutje filloi me leximin nen për nen të Projektligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, ku nga ky lexim në nenin 6 të tij, paragrafi 3 “I huaji subjekt i paragrafit 1 të këtij Neni ka të drejtë ankese në gjykatën kompetente”

Bëri pyetje se gjithsesi personi mund të bëjë ankesë në se Agjencia e Kosovës për Inteligjencë nuk i jep lejen për të marrë shtetësi?

Shkodran Manaj- Tha se për këtë çështje kanë pranuar komente nga BE-ja, por ky ligj dhe direktivat e BE-së e kërkojnë që në rastin kur i jepet shtetësia një personi, ai nuk duhet të jetë i cenueshëm për Republikën e Kosovës, por e drejta e kërkuarit të shtetësisë është që mund të parashtroj ankesë në Gjykatë.

Fatmir Xhelili- Tutje vazhdoi leximin nene për nen të Projektligjit për të Huajt.

Anton Quni- Bëri pyetje për përfaqësuesit e MPB-së për Nenin 11, paragraf 5” Viza e lëshuar nuk garanton hyrjen e të huajt në Republikën e Kosovës”

Shkodran Manaj- Ky është standard i çdo shteti dhe është zyrtari policor i cili në vendkalimin kufitar mund të vlerësoj si të papërshtatshëm kalimin e kufirit për një person të caktuar edhe pse posedon vizë.

Ndërsa propozoi se në Nenin 16, paragrafi 1 dhe 2 të fshihen pasi janë të përfshira në nenin 11 të këtij Projektligji.

Fatmir Xhelili- Për këtë çështje propozoi amendamentin si në vijim:

Në nenin 16 të Projektligjit për të Huajt, paragrafi 1 dhe 2 fshihen, pasi të njëjtit janë në Nenin 11, paragrafin 1 dhe 4.

Shkodran Manaj- Për nenin 26 të këtij projektligji, paragrafi 2 është i njëjtë me paragrafin 1.5, dhe mbetet paragrafi 1.5. “Parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë ne gjendje të parashtrojë kërkesë për vize paraprakisht dhe të dorëzojë, nëse kërkohet, dokumente shtesë që mbështesin arsyet e paparashikueshme dhe të domosdoshme për hyrje”

Fatmir Xhelili- Bëri vërejtje për përdorimin në tekstin e projektligjit të përemrave ai/ajo, për të cilën u tha nga përfaqësuesit e MPB-së, se përcaktohet me direktivat e BE-së.

Shkodran Manaj- Shtoi se tek neni 49 i këtij projektligji, paragrafi 4 të riformulohet , pasi është bërë një lëshim nga përkthimi i tekstit nga anglishtja në gjuhën shqipe, ku termi “outside” në tekstin shqip të këtij paragrafi është përkthyer “brenda”.

Riformulimi mund të bëhet si në vijim ”Parashtrimi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm, me qëllim të bashkimit familjar do të dorëzohet për anëtarët e familjes që janë duke jetuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës”

Rexhep Selimi- Kërkoi që të përcaktohet saktë kjo çështje pasi mund të keqpërdorët nga persona që duan të përfitojnë shtetësinë e Kosovës.

Shkodran Manaj- Shtoi se tek neni 52 i këtij projektligji është një gabim teknik, dhe në vend të nenit 51 duhet të jetë neni 50, në të tre gjuhët dhe kjo duhet të shkojë si amendament. Gjithashtu në paragrafin 2, të nenit 49, në gjuhën angleze, neni 49, duhet të jetë neni 48.

Ndërsa në nenin 52, duhet të shtohet një paragraf i ri si në vijim” Personat të cilët parashtrojnë kërkesë për qëndrim të përkohshëm, me qëllim të ribashkimit familjar, duhet tu krijohen lehtësira për vizë të nevojshme”

Gjithashtu tek neni 59, paragrafi 1.1, të shtohet që në tekstin e mëtejshëm i referohet si viktimë, për viktimat e trafikimit, pasi në versionin anglisht dhe serbisht është kështu.

Rexhep Selimi- Kërkoi që në tekstin e projektligjit “fjala mungon nga territori i Kosovës” të ndryshohet pasi nuk ka kuptimin e duhur për këtë tekst të projektligjit.

Minire Begaj-MPMS- Në tekstin ku thuhet “me kontrata kolektive” zëvendësohet me vendim të Qeverisë, propozoj që ky të jetë amendament.

Habibe Zeqiri, Departamenti për Azil- Propozoi që në gjithë tekstin e projektligjit fjala i mitur zëvendësohet me fëmijë, dhe kjo është rekomandim nga Komisioni Evropian

Si përfundim, pas shqyrtimit të këtij projektligji u propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Në paragrafin 4 të nenit 9 në gjuhën angleze fjala “MIA” zëvendësohet me fjalën “Government” ndërsa në gjuhën serbe fjala “MUP” duhet të zëvendësohet me fjalën “Vlada”

Amendamenti 2

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 16 të fshihen.

Amendamenti 3

Në paragrafin 1 të nenit 17 fjala “jo më herët” të zëvendësohet me fjalën “jo më vonë”.

Amendamenti 4

Paragrafi 2 i nenit 26 fshihet.

Amendamenti 5

Në paragrafin 3 të nenit 29 në gjuhën serbe fjala “OTKAZANO” zëvendësohet me fjalën “ANNULLED” kurse fjala “ODUZETO” zëvendësohet me fjalën “REVOKED”

Amendamenti 6

Në paragrafin 2 të nenit 44, në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 95 dhe në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 98, pas fjalës “komision” shtohet fjala “i ankesave”.

Amendamenti 7

Paragrafi 4 i nenit 49 riformulohet si në vijim:

“Parashtrimi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar do të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes janë duke qëndruar jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Përgjatimisht, në rrethana të caktuara, kërkesa për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar mund të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes gjenden në territorin e Republikës së Kosovës”

Amendamenti 8

Në paragrafin 1.1, paragrafi 1 i nenit 50 pas fjalës “bashkëshortët” shtohet fjala “ose partnerët”.

Amendamenti 9

Në paragrafin 1 të nenit 52 fjala “të nenit 51” të zëvendësohet me fjalën “të nenit 50” në tri gjuhët dhe në paragrafin 2 të këtij nenin vetëm në gjuhën angleze fjala “nenin 49” zëvendësohet me fjalën “neni 48”.

Amendamenti 10

Pas paragrafit 4 të nenit 52 shtohet një paragraf i ri si në vijim:

“Personave të cilët parashtrojnë kërkesë për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar do t’u krijohen lehtësira për pajisje me vizë të nevojshme”

Amendamenti 11

Në paragrafi 1.1 të nenit 59 në gjuhën shqipe pas fjalës “trafikimit me njerëz” shtohet fjala “(në tekstin e mëtejshëm viktimë)”

Amendamenti 12

Në paragrafin 4 të nenit 66 fjala “mungon nga Republika e Kosovës” zëvendësohet me fjalën “qëndron jashtë Republikës së Kosovës”

Amendamenti 13

Në paragrafin 2 të nenit 50 dhe në paragrafët 3.2 dhe 3.3 në paragrafin 3 të nenit 67 fjala “status i azilit” zëvendësohet me fjalën “status i refugjatit”.

Amendamenti 14

Në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 67 fjala “mbi” zëvendësohet me fjalën “për”

Amendamenti 15

Në paragrafin 1.8 të nenit 81 “me marrëveshje kolektive” zëvendësohet me fjalën “ me aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria”

Amendamenti 16

Në paragrafin 1 të nenit 99 pas fjalës “Urdhri i dëbimit” shtohet fjala “jepet nga DSHAM”.

Amendamenti 17

Në paragrafin 1 të nenit 129 dhe paragrafin 1 të nenit 131 në gjuhën angleze shtohet fjala “by police” dhe serbe “od straten policije” për tu harmonizuar me variantin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 18

Në paragrafin 1 të nenit 130 në gjuhën angleze dhe serbe shtohet fjala “Labour Inspectorate” dhe “Inspektorata za rada” për tu harmonizuar me variantin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 19

Në paragrafin 1.1 të nenit 137 në gjuhën angleze pas fjalës “according” shtohet fjaka “article 7”, për tu harmonizuar me variantin shqip dhe serbisht.

Amendamenti 20

Në paragrafin 1.6 të nenit 137, fjala “neni 95” zëvendësohet me fjalën “neni 94” në tri gjuhët.

Amendamenti 21

Në paragrafin 1.28 të nenit 3, në paragrafin 1 të nenit 43, në paragrafin 3 të nenit 52, në nën paragrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 96, në nën paragrafët 1.3 dhe 1.6, të paragrafit 1 të nenit 100, dhe në titullin dhe tekstin e nenit 112 fjalët “i mitur i pashoqëruar” zëvendësohen me fjalët “fëmijë i pashoqëruar” vetëm në gjuhën shqipe.

Amendamenti 22

Në nenin 61 fjalët “nuk duhet të jetë më e shkurtër se 3 muaj” zëvendësohet me fjalët “duhet të jetë prej 30 deri 90 ditë”

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-217 për Azil.

Kryesuesi- Duke vazhduar leximin nen për nen të këtij projektligji dhe në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit dhe përfaqësuesit e MPB-së të departamenteve përkatëse, nxorën këto amendamente:

Amendamenti 1

Në pikën 2 të nën paragrafit 1.19, në nën paragrafët 1.21 dhe 1.23 të nenit 2, në paragrafin 1 dhe në nën paragrafin 7.3 dhe 7.4 të nenit 14, në nën paragrafin 1.6 të nenit

19, në paragrafin 3 të nenit 54 dhe në paragrafin 1 të nenit 95 fjala “i mitur” zëvendësohet me fjalën “fëmijë”

Amendamenti 2

Pas nenit 98 shtohet nen i ri si në vijim:

Neni 99 Përcaktimi i vendeve të Sigurta

Qeveria e Kosovës me vendim përcakton listën e vendeve të sigurta e cila mund ti nënshtrohet një shqyrtimi periodik.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit.

Kryesuesi- Duke vazhduar shqyrtimin e këtij projektligji, propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Fjala “Ndërkufij” zëvendësohet me fjalën “ndërkufitar” në tërë tekstin e Projektligjit.

Amendamenti 2

Kreu III dhe neni 7 fjala “Agjencia” zëvendësohet me fjalën “Autoriteteve”

Amendamenti 3

Neni 12 Titulli dhe tërë teksti i nenit fjala “ Marrëveshjet” zëvendësohet me fjalën “Marrëveshjet ndërmjet Autoriteteve”

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Kryesuesi- Pas leximit nen për nen të këtij projektligji dhe shqyrtimit të tij me të pranishmit, konstatoi këto amendamente:

Amendamenti 1

Neni 8, të ndryshohet titulli i nenit nga “Emërimi i Koordinatorit” të zëvendësohet me “Emërimi dhe Kompetencat e Koordinatorit”

Amendamenti 2

Neni 11, paragrafi 4 fjala “mund” të bëhet “duhet”

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Kryesuesi- Pas leximit nen për nen të këtij projektligji dhe shqyrtimit të tij me të pranishmit, konstatoi këto amendamente:

Amendamenti 1

Në nenin 10 me të cilin riformulohet neni i ri 26A me titull “Trafiku lokal kufitar” i ligjit bazik fjalët “banorët kufitar” zëvendësohen me fjalët “banorët e zonës kufitare”

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.

Kryesuesi- Pas leximit nen për nen të këtij projektligji dhe shqyrtimit të tij me të pranishmit, konstatoi këto amendamente:

Amendamenti 1

Mbi titullin e nenit 6, fjalia “1. Fitimi i shtetësisë me lindje” fshihet.

Amendamenti 2

Mbi titullin e nenit 8, fjalia: “2. Fitimi i shtetësisë me adoptim” fshihet.

Amendamenti 3

Mbi titullin e nenit 9, fjalia: “3. Fitimi i shtetësisë me natyralizim” fshihet.

Amendamenti 4

Nën paragrafi 2.1 i paragrafit 2. të nenit 24, riformulohet si vijon.

Kur shtetasi qëllimisht i është bashkuar një organizate e cila ka për qëllim rrënimin ose dëmtimin e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës, ose”

Në mbyllje të këtij takimi, falënderoi përfaqësuesit e OSBE-së, MPB-së dhe Zyrën Ligjore të Kuvendit dhe me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi